



# GJYKATA E LARTË

## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Për një drejtësi efektive**

## Mesazh i Zëvendëskryetarit të Gjykatës

Pritshmëria e lartë e opinionit publik për një sistem drejtësie efektiv, cilësor dhe të aksesueshëm nga shtetasit në të gjitha nivelet kërkon një tjetër performancë edhe për institucionin më të lartë të dhënies së drejtësisë. Gjykata e Lartë po përballet me një proces të rëndësishëm zhvillimi dhe ndryshimi që synon të japë shpresën dhe besimin se drejtësia do të bëhet.

Pozicionimi i ri kushtetues e ka vendosur Gjykatën e Lartë përballë sfidave të mëdha për reformatimin e kolegjeve me gjyqtarë sa më cilësorë për realizimin e një vendimmarrje gjyqësore efektive, përshtatjen e strukturës organizative të saj me nevojat e gjykimit, që paraqiten nga ky realitet i ri kushtetues dhe ligjor, orientimin drejt një metodologjie të qartë për uljen e numrit tepër të lartë të çështjeve të prapambetura ndër vite, si edhe rikthimin e gjykatës supreme në pozicionin natyror të një gjykate ligji, që si drejtim kryesor ka njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Fitimi i legjitimitetit juridiksional dhe jurisprudencial për Gjykatën e Lartë, nëpërmjet orientimit të saj strategjik dhe rritjes së performancës së duhur në sjellje dhe në vendimmarrje solide, me synim fitimin e besimit të publikut është dhe do të mbetet një mision jo i pamundur për ne.

Pas një periudhe mosfunksionimi tërësor të Gjykatës së Lartë, me fillimin në mars të vitit 2020 të detyrës nga tre gjyqtarët e parë të kësaj gjykate, nisi edhe vendimmarrja e çështjeve të natyrës administrative, civile e penale, nëpërmjet mbajtjes së qëndrimeve solide për konsolidimin e praktikës gjyqësore, ashtu siç u adresuan edhe problemet që paraqiste numri i madh i çështjeve të regjistruara por të pashqyrtuara, me të cilat do të përballej në vijim veprimtaria e kësaj gjykate.

Më 29 korrik 2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Gjykata e Lartë paraqitën “Udhërrëfyesin për Funksonimin e Gjykatës së Lartë” që do të udhëzonte rrugëtimin për plotësimin e trupës gjyqësore të gjykatës, zbatimin e elementeve kyçe të legjislacionit të reformës në drejtësi, garantimin e punësimit të stafit të nevojshëm administrativ në mbështetje të gjyqtarëve, si dhe trajtimin e një volumi të madh prej më shumë se 36.000 çështjesh të prapambetura (*shih “Udhërrëfyesin” në linkun <http://klgj.al/udherrefyes-per-funksionalitetin-e-gjykates-se-larte/>*).

Sukseset e arritura janë theksuar më poshtë, në pjesën me titull “Arritjet”, megjithatë përballja me sfidat mbetet e pranishme në drejtim të:

- ❖ Plotësimin të trupës së Gjykatës së Lartë edhe me 9 gjyqtarë të tjerë;
- ❖ Angazhimin serioz të gjykatave të shkallëve më të ulëta me kontrollin (filtrimin) e rekrutimit, përpara se ato t’i dërgohen Gjykatës së Lartë;
- ❖ Konsolidimin të praktikës gjyqësore nga gjykatat e apelit drejt vendimmarrjeve të njëjta për çështje të ngjashme, për të cilat kanë mbajtur qëndrim kolegjet e Gjykatës së Lartë;
- ❖ Ndërgjegjësimin më të mirë të avokatëve dhe qytetarëve lidhur me rolin e ri të Gjykatës së Lartë, ashtu siç përcaktohet në ndryshimet thelbësore të reformës së

vitit 2016, me qëllim uljen e rekurseve që nuk përmbushin kriteret ligjore dhe përshtatjen me misionin dhe funksionin që ka kjo Gjykatë;

- ❖ Ngritjes dhe formësimit të Qendrës së Dokumentacionit, siç është ideuar në paketën e reformës së vitit 2016, duke rekrutuar një staf sa më të përshtatshëm, me synim shndërrimin e saj në strukturën bazë që ndihmon për një vendimmarrje më cilësore dhe që orientohet nga standardet më të mira ndërkombëtare;
- ❖ Plotësimit të administratës së Gjykatës së Lartë me staf të profilizuar që siguron rritjen e efektivitetit dhe të cilësisë së punës së gjyqtarëve;
- ❖ Ndjekjes në vijimësi të proceseve administrative të Gjykatës për zbatimin e masave efikase, si dhe gjetjen e rrugëve të reja për të rritur efikasitetin e saj;
- ❖ Gjetjes së zgjidhjeve emergjente për infrastrukturën e Gjykatës së Lartë deri në konkretizimin me një zgjidhje përfundimtare, për të bërë të mundur përballimin e vëllimit tepër të lartë të çështjeve që presin për t'u shqyrtuar, por edhe të atyre që shtohen përditë;
- ❖ Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemeve të TIK-ut të Gjykatës për arritjen e funksionalitetit maksimal.

Një vit më pas, ky plan veprimi hartohet në vijim të “*Udhërrëfyesit për Funksionimin e Gjykatës së Lartë*” dhe ka si qëllim të dokumentojë arritjet dhe sfidat ende të pranishme. Qasja në drejtësi, administrimi më eficient dhe efektiv i saj, si dhe rritja e besueshmërisë së munguar në sytë e publikut janë përparësitë kryesore të kësaj Gjykate. Të gjitha këto do të jenë të arritshme përmes një partneriteti të vazhdueshëm e profesionalisht të lartë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, institucionet vendore, si dhe partnerët ndërkombëtarë. Ky plan veprimi rishikohet periodikisht me qëllim evidentimin e ecurisë dhe nevojave aktuale të Gjykatës.

Sokol Sadushi  
Zëvendëskryetar i Gjykatës së Lartë

## Arritjet

Që prej fillimit të punës në muajin mars të vitit 2020, si dhe prezantimit të “Udhërrëfyesit” në muajin korrik të atij viti, ka arritje të konsiderueshme drejt përmirësimit të funksionimit të Gjykatës së Lartë:

- ❖ Në Gjykatë janë duke ushtruar detyrën nëntë (9) gjyqtarë:
  - Gjyqtarët Sokol Sadushi, Ilir Panda dhe Ervin Pupe janë në detyrë prej muajit mars të vitit 2020;
  - Gjyqtarët Sokol Binaj, Albana Boksi, Sandër Simoni, Klodian Kurushi janë në detyrë prej muajit mars të vitit 2021;
  - Gjyqtarët Artur Kalaja dhe Asim Vokshi janë në detyrë prej korrikut të vitit 2021;
  - Gjyqtari Medi Bici shërben si anëtar me kohë të plotë në KLGJ, deri më 12.12.2021, kur edhe i mbaron mandati 3 vjeçar. Pasardhësi i gjyqtar Medi Bicit si anëtar i KLGJ i zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, do të jetë z. Klodian Kurushi, i zgjedhur nga Mledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve në datë 8.10.2021.
- ❖ Gjykata ka në funksion aktiv 10 (dhjetë) trupa gjykuese:
  - 3 (tre) për çështje administrative, prej të cilave 2 (dy) janë të përhershme dhe 1 (një) trupë e veçantë;
  - 3 (tre) për çështje civile, prej të cilave 2 (dy) janë të përhershme dhe 1 (një) trupë e veçantë;
  - 4 (katër) për çështje penale, prej të cilave 2 (dy) janë të përhershme dhe 2 (dy) janë të veçanta.
- ❖ Gjykata ngriti Këshillin e Gjykatës si një organ udhëheqës që është mbledhur 9 herë dhe ka miratuar 68 vendime, në mbështetje të administrimit më të mirë të drejtësisë:
  - Kryetari i Këshillit të Gjykatës – Zëvendëskryetari i Gjykatës, gjyqtari Sokol Sadushi
  - Zëvendëskryetari i Këshillit të Gjykatës - gjyqtari Ilir Panda
  - Anëtar i Këshillit të Gjykatës - Kelment Greca, Drejtor i Organizimit të Gjykatave dhe Standardeve në KLGJ.
- ❖ Sipas kërkesave të ligjit, Gjykata ka organizuar Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve dhe ka zgjedhur gjyqtarin Sokol Sadushi, si Zëvendëskryetar të Gjykatës për një mandat 3 vjeçar.
- ❖ Sipas kërkesave të ligjit, u zhvillua mbledhja e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili zgjodhi gjyqtarin Ilir Panda në funksionin e Kryetarit të këtij Kolegji.
- ❖ KLGJ ka shpallur vendet e lira për gjyqtarë, nga të cilat priten 6 emërime të reja, deri në fund të vitit 2021.
- ❖ Prej vitit 2020, Gjykata ka ngritur Njësinë e Shërbimit Ligjor, e cila përbëhet nga 20 këshilltarë ligjorë, pjesërisht ndihmësmagjistratë të komanduar për një periudhë 3 vjeçare në Gjykatën e Lartë dhe pjesërisht këshilltarë të formuar nga Shkolla e Magjistraturës për këtë profil, si dhe këshilltarë të tjerë ligjorë që janë emëruar nga KLGJ sipas kuadrit ligjor të miratuar pas reformës së 2016. Janë ende në proces vlerësimi nga ana e KLGJ edhe 2 (dy) këshilltarë ligjorë që kanë përfunduar Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për

vitin akademik 2020 – 2021, si dhe pritjet përmbushja nga KLGJ e detyrimit ligjor për komandimin e të paktën 5 (pesë) ndihmësmagjistratëve, që vijnë nga radhët e sistemit.

- ❖ Këshilli i Gjykatës së Lartë, në kuadër të detyrimeve të veta ligjore, ka miratuar strukturën dhe organigramën e Gjykatës. Është ende në proces plotësimi të vazhdueshëm njësia më e re e saj, Qendra e Dokumentacionit, e cila do të ndihmojë këshilltarët dhe gjyqtarët e kësaj Gjykate në përhapjen dhe njohjen e vendimmarrjes së saj për publikun, si dhe në njohjen e gjyqtarëve me praktikën e gjykatave ndërkombëtare.
- ❖ Gjykata ka dhënë kontributin e saj gjatë procesit të hartimit të ndryshimeve ligjore që i shërbejnë rritjes së efikasitetit dhe parandalimit të rritjes së numrit të çështjeve të prapambetura në të ardhmen. Ndryshimet e miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë në mars të vitit 2021, të cilat kanë hyrë në fuqi në maj të vitit 2021, orientohen drejt:
  - Qartësimin dhe saktësimin të detyrimit që kanë gjykatat e shkallëve më të ulëta për zbatimin e sistemeve të filtrimit, përpara paraqitjes së çështjeve në Gjykatën e Lartë,
  - Identifikimin të qartë dhe njësimit të shkaqeve ligjore, për të cilat lejohet paraqitja e rekursit,
  - Përcaktimin të qartë të numrit të nevojshëm të gjyqtarëve për krijimin e trupave gjyqësore për kategori të caktuara çështjesh,
  - Përcaktimin dhe organizimin më të mirë të rolit të Gjykatës së Lartë, lidhur me njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore,
  - Përkufizimin më të mirë të kategorive të çështjeve që duhet të gjykohen shpejt, bazuar në procedurën e gjykimit të përshpejtuar,
  - Sigurimin të mjeteve ligjore që i lejojnë Gjykatës së Lartë të zbatojë penaltete, kur rekursat ose kërkesat e dorëzuara janë abuzive (pa një bazë ligjore, ose kur dorëzohen me qëllim për të shkaktuar vonesa të gjykimit),
  - Zgjerimin dhe njësimit të rolit dhe funksionit të dhomës së këshillimit në të gjitha llojet e çështjeve, si një praktikë e mirë që do ta bëjë Gjykatën e Lartë më efikase ([http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Baza\\_ligjore\\_9900\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Baza_ligjore_9900_1.php))
- ❖ Projekti i USAID “Drejtësi për të gjithë” e transferoi mbështetjen teknike dhe financiare për *Nëpunësit e Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura* (NUNÇP), që do të vijojnë të jenë pjesë e Gjykatës së Lartë deri në mars të vitit 2022, te INL (Byroja për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Ligjzbatimit), që mbështetet nga Ambasada e SHBA-së në Tiranë,
- ❖ U vendos bashkëpunimi me EURALIUS V për përforcimin e kapaciteteve të Gjykatës, përmes sigurimit të praktikave më të mira, lidhur me kërkimin ligjor dhe ndërgjegjësimin publik për rolin e ri të saj,
- ❖ U mundësua pjesëmarrja në 5 trajnime, veprimtari për rritjen e kapaciteteve dhe shkëmbime me homologë ndërkombëtarë, për të siguruar që gjyqtarët dhe stafi janë të angazhuar vazhdimisht në zhvillim profesional dhe në dijeni të prirjeve më të reja dhe praktikave më të mira,

- ❖ Gjykata e Lartë u përball me kufizimet në kuadër të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, si dhe të gjitha vështirësitë që e shoqëruan atë, ndërkohë që u përpoq maksimalisht dhe pa e ndërprerë asnjë ditë veprimtarinë gjyqësore,
  - ❖ Në periudhën prill - dhjetor 2020 janë marrë 1957 vendime gjyqësore nga vetëm tre gjyqtarë, sa 83% e të gjitha vendimeve të marra në vitin 2018, me trupë të plotë gjyqtarësh. Në periudhën prill 2020 - tetor 2021 u morën **4,788** vendime gjyqësore,
  - ❖ U hartua strategjia e pranisë në publik për zbatimin e një fushate ndërgjegjësimi për rritjen e besimit,
  - ❖ U hapën profilet zyrtare të Gjykatës në Facebook dhe LinkedIn për komunikim më të mirë me qytetarët, si dhe u rikonceptua logo dhe faqja web e Gjykatës për të qenë më miqësore për përdoruesit, <https://www.facebook.com/GjykataeLarte/> <https://www.linkedin.com/company/gjykata-e-lart%C3%AB-erepublik%C3%ABs-s%C3%AB-shqip%C3%ABris%C3%AB>
  - ❖ Mjediset e shërbimit për klientin në gjykatë u riformatuan dhe tashmë janë të hapura për qytetarët gjatë orarit zyrtar. Godina është e pajisur me sinjalistikë drejtuese më orientuese dhe mikëpritëse,
  - ❖ Gjykata e Lartë ka organizuar takime me bashkëpunëtorët e saj për të siguruar që proceset e reja, ndryshimet e legjislacionit dhe ndryshimet e tjera në gjykatë të kuptohen qartë, si brenda gjyqësorit, ashtu edhe nga bashkëpunëtorët jashtë tij. Gjykata është angazhuar të organizojë periodikisht këto takime,
  - ❖ Janë botuar 4 broshura informuese, që tashmë janë të disponueshme në faqen zyrtare të saj dhe në shtyp:
    - Udhëzime për paraqitjen dhe shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë,
    - Gjykata e Lartë dhe Publiku,
    - Paraqitja e rekurseve në Gjykatën e Lartë,
    - Si funksionon Gjykata e Lartë?
- [http://www.gjykataelarte.gov.al/web/rrequllat\\_e\\_rekursit\\_ne\\_gjl\\_2021\\_5779.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/rrequllat_e_rekursit_ne_gjl_2021_5779.pdf)  
[https://www.linkedin.com/posts/gjykata-e-lart%C3%AB-erepublik%C3%ABs-s%C3%AB-shqip%C3%ABris%C3%AB\\_n%C3%AB-ambjentetpr%C3%ABse-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-s%C3%AB-lart%C3%ABactivity-6788020982473916416-nËp\\_](https://www.linkedin.com/posts/gjykata-e-lart%C3%AB-erepublik%C3%ABs-s%C3%AB-shqip%C3%ABris%C3%AB_n%C3%AB-ambjentetpr%C3%ABse-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-s%C3%AB-lart%C3%ABactivity-6788020982473916416-nËp_)
- ❖ Gjykata bashkëpunoi me Projektin e USAID “Drejtësi për të gjithë” për të përmirësuar sistemin elektronik të administrimit të çështjeve në gjykatë (ICMIS) dhe për ta mirëmbajtur atë për një periudhë 12 mujore,
  - ❖ Gjykata shpalli tre vende vakante për Gjykatën Kushtetuese.

\*\*\*\*\*

Nga fillimi i vitit deri në datën e raportit për vitin 2021 u arrit një Normë e Evadimit të Çështjeve (raporti midis çështjeve të zgjidhura dhe atyre të regjistruara rishtazi) prej **120%**. Duhet theksuar se kjo normë tejkalon të gjitha rekomandimet/standardet minimale ndërkombëtare që janë në raportin 1:1 ose 100%

➢ Nga 1 janari 2021 deri në 31 tetor 2021 janë dhënë 2,513 vendime, për çështje të ardhura me rekurs/kompetencë, juridiksion, si dhe 300 vendime me objekt pezullim/revokim/konstatim shkelje afati etj. Gjithsej nga të tre kolegjet janë marrë

2,813

vendime.

➤ Nga 1 janari 2021 deri në 31 tetor 2021 janë regjistruar 2,335 çështje të reja (penale, civile dhe administrative).

## Orientime nëpërmjet vendimmarrjes

### ❖ që vendosin praktikë gjyqësore

Rifunksionimi i Gjykatës së Lartë me një bazë të re kushtetuese dhe ligjore kërkoi mbajtjen nga trupa gjyqësore të qëndrimeve që sollën risi dhe zgjidhën dilemat që kishin ekzistuar, por edhe që konsoliduan praktikën gjyqësore për të ardhmen, të cilat u pasqyruan në disa vendime të rëndësishme. Kjo vendimmarrje publikohet në vazhdimësi dhe në mënyrë të plotë në faqen e Gjykatës dhe llogaritë në rrjetet sociale për t'i ardhur në ndihmë zbatuesve të së drejtës dhe opinionit publik. Këtu po sjellim disa shembuj:

\*\*\*\*\*

Kolegji Administrativ:

➤ Në çështjen administrative nr. 31001-00130-2015 ka trajtuar aspekte thelbësore mbi; mosdëbimin e shtetasve të huaj, shtetasve shqiptarë, mbrojtjes së veçantë që gëzojnë fëmijët në procedurat administrative dhe gjyqësore të kësaj natyre, aksesit gjyqësor në të dhënat e klasifikuara "sekret shtetëror" dhe roli i gjykatave, si edhe të drejtat procedurale të palëve ndërgjyqëse, në gjykimet sensitive të kësaj natyre. [http://gjykataelarte.gov.al/web/9\\_00\\_2021\\_142\\_4506.doc](http://gjykataelarte.gov.al/web/9_00_2021_142_4506.doc),

➤ Në çështjen administrative me nr. 31003-00131-00-2021 ka trajtuar shtrirjen e juridiksionit gjyqësor shqiptar ndaj Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe ka përcaktuar juridiksionin gjyqësor, në rastet kur paditësi kundërshton vendimin e Kuvendit të Shqipërisë për miratimin e listës së kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit. [http://gjykataelarte.gov.al/web/00\\_2021\\_253\\_4604.doc](http://gjykataelarte.gov.al/web/00_2021_253_4604.doc),

➤ Në çështjen administrative me nr. 31001-01287-00-2015 ka analizuar të drejtën e ankimit kundër një vendimi gjyqësor, në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012; natyrën juridike dhe raportin ndërmjet sanksioneve të parashikuara në nenin 184 të Kodit Rrugor; faktin nëse mund të kufizohet e drejta e ankimit në gjykatën më të lartë për aktin administrativ, pezullimin e lejes së drejtimit, etj. [http://gjykataelarte.gov.al/web/Njoftim\\_per\\_publicun\\_9920\\_1.php](http://gjykataelarte.gov.al/web/Njoftim_per_publicun_9920_1.php)



\*\*\*\*\*

Kolegji Civil:

➤ Lidhur me çështjen civile me nr. 11243-1972-00-2019 ka trajtuar koncepte të tilla si: gjyqvarësia dhe gjëja e gjykuar; kuptimi i padive që nuk mund të ngrihen; faza procedurale se kur duhet të verifikohen nga gjykatat, pengesa të tilla që nuk lejojnë shqyrtimin meritore të çështjes; nëse mund të merret masë sigurimi sipas neneve 202 e vijues të KPC, në lidhje me një padi që nuk mund të ngrihet, etj.  
[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/5\\_00\\_2021\\_139\\_4829.doc](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/5_00_2021_139_4829.doc)

➤ Lidhur me çështjen civile me nr. 11243-01574-2019 ka trajtuar koncepte të tilla si pezullimi i gjykimit, koneksiteti midis dy çështjeve në kuptim të nenit 297/a të KPC, si ndikon procesi penal mbi falsitetin e dokumentin në gjykimin civil, a kushtëzohet i dyti nga i pari etj. Në këtë çështje Kolegji ka konkluduar se gjykimi penal dhe ai civil mbi falsitetin e dokumentit mund të zhvillohen edhe në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri dhe se vetëm paraqitja e një kallëzimi penal në lidhje me falsitetin e dokumentit ndërkohë që ka vijuar gjykimi civil nuk mund të shërbejë si shkak pezullues në çdo rast, sipas nenit 297/a të KPC. Një interpretim i kundërt i ligjit do të nxiste çdo pale ndërgjyqëse, që të përdorte kallëzimin penal si mjet për të zvarritur gjykimin civil.  
[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/00\\_2020\\_696\\_4106.doc](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/00_2020_696_4106.doc)

➤ Në çështjen civile me nr. 11243-00248-00-2021, Kolegji ka trajtuar kompetencën lëndore të gjykatave për shqyrtimin e padive me objekt pavërtetësinë e dokumenteve në lidhje me të drejtën e pensionit. Kolegji ka konkluduar se shqyrtimi i padive të tilla deklarative është në kompetencën lëndore të gjykatave administrative, duke qënë se kanë natyrë parajyqimore në raport me paditë e themelit, me objekt njohjen apo dhënien e së drejtës së pensionit, kundrejt organit të administratës publike.  
[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/00\\_2021\\_597\\_5113.doc](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/00_2021_597_5113.doc)

➤ Lidhur me çështjen civile me nr. 11243-02307-2019, Kolegji ka trajtuar disa institute si: masat e sigurimit të padisë, sipas neneve 202 e vijues të KPC; regjistrimi i padive reale në regjistrat publikë, sipas nenit 197 të KC; nëse mund të sigurohet me masë sigurimi çdo lloj padie etj. Në këtë çështje Kolegji ka konkluduar se ekzistenca e një procesi gjyqësor me objekt të drejtat reale mbi një send të paluajtshëm nuk legjitimon *apriori* kufizimin e qarkullimit civil mbi atë send dhe pezullimin e kryerjes së veprimeve juridike mbi të dhe se qëllimi i synuar nga pala ndërgjyqëse nëpërmjet kërkesës për sigurimin e padisë arrihet nëpërmjet regjistrimit të padisë sipas nenit 197/b të KC.  
[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/00\\_2020\\_728\\_4044.doc](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/00_2020_728_4044.doc)



\*\*\*\*\*

Kolegji Penal:

➤ Lidhur me çështjen penale me nr. 52111-790-2020 ka trajtuar se ndaj vendimit të seancës paraprake nuk parashikohet e drejta e ankimit, sepse shkeljet procedurale që mund të kostatohen në seancë paraprake mund të rregullohen gjatë gjykimit të themelit. Në këtë linjë arsyetimi, gjyqtari i themelit nuk ka të drejtë të shpallë të pavlefshëm vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake, por ka të drejtën dhe detyrimin të

korrigjojë shkeljet procedurale që konstaton se janë kryer në seancë paraprake.

[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/00\\_2020\\_485\\_4158.doc](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/00_2020_485_4158.doc)

➤ Në çështjen penale me nr. 70007-00188-2016 ka analizuar detyrimin e shtetit shqiptar për të garantuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, konkretisht ndalimin e trajtimit çnjerëzor dhe degradues, sipas nenit 3 të Konventës. Në këtë vendim është konstatuar se, pavarësisht se në çështjen Strazimiri kundër Shqipërisë, shteti shqiptar është gjetur fajtor në lidhje me mospërmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga nenet 3 dhe 5 të Konventës, institucionet përgjegjëse nuk morën masa për të ekzekutuar vendimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

➤ Në çështjen penale nr. 1, datë 01.06.2021 ka trajtuar mënyrën e gjykimit të kërkesës penale me objekt revokim vendimi i pushimit të procedimit penal; përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë që shqyrton një kërkesë të tillë; ligjin procedural të zbatueshëm për çështjet penale që kishin nisur para hyrjes në fuqi të ndryshimeve dhe kompetencën lëndore të Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e kërkesës për revokim vendimi pushimi, në kushtet kur vendimi i pushimit është dhënë prej kësaj gjykate, para ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të miratuara me ligjet nr. 76/2016 dhe nr. 35/2017.

### ❖ **që njësojnë praktikat e ndryshme gjyqësore**

Ridimensionimi kushtetues i Gjykatës së Lartë, si autoriteti që siguron njësimin dhe

zhvillimin e praktikës gjyqësore, ndihmon në orientimin e gjykatave dhe të praktikantëve të së drejtës për të shmangur dilemat në mënyrën e kuptimit dhe interpretimit të ligjit dhe në realizimin e vendimmarrjeve gjyqësore të drejta. Vendimet njësuere janë gjithashtu një mekanizëm i rëndësishëm për të shmangur mbingarkesën e Gjykatës së Lartë nga rekurset e panevojshme, por edhe për të ulur ndjeshëm numrin e çështjeve të prapambetura që kanë mbetur pa u shqyrtuar në vite.

\*\*\*\*\*

Kolegji Administrativ:

➤ Në çështjen me nr.31003-01562-00-2018, ka njësuar praktikën gjyqësore duke konkluduar se procesi i fitimit të gradave policore nga niveli “Nënkomisar” deri në nivelin “Drejtues i Parë”, duhet t’i nënshtrohet domosdoshmërisht procedurës së vlerësimit konkurrues, sipas parashikimeve të neneve 50-60 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe se plotësimi I kriterëve formale për fitimin e gradës, si vjetërsia në gradën pararendëse dhe/ose ushtrimi efektiv i funksionit në përputhje me gradën e pretenduar, nuk mund të sjellin fitimin gjyqësisht të gradës policore, pa iu nënshtuar më pare procesit të vlerësimit konkurrues nga komisioni i gradimit.

[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/102\\_00\\_2021\\_1215\\_6011.doc](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/102_00_2021_1215_6011.doc)

\*\*\*\*\*

Kolegji Administrativ:

➤ Në çështjen administrative me nr. 31003-03553-00-2014 ka njësuar praktikën gjyqësore duke konkluduar se: Ligji nr. 7703/1993, i ndryshuar në vitin 2011, nuk plotëson të gjitha standardet e vendosura nga GJEDNJ, në çështjen “*Dauti kundër Shqipërisë*” dhe standardet kushtetuese të gjykatës së caktuar me ligj, mbi pavarësinë

dhe patundshmërinë e anëtarëve të KMCAP Epror, sipas nenit 6 të KEDNJ së dhe nenit 42 të Kushtetutës. Si përfundim, Kolegji vlerësoi se KMCAP Epror, sipas rregullimit që i ka bërë ligji, nuk është formësuar si një organ *kuazi* gjyqësor. Përderisa nuk plotëson këtë kusht thelbësor, nuk mundet që paditë kundër vendimeve të KMCAP Epror të mos i nënshtrohen kontrollit gjyqësor dhe këto vendime nuk mund të përcaktohen nga ligji si akte administrative të pakundërshtueshme gjyqësisht; Neni 39/1, pika 3 i ligjit nr. 7703/1993, në pjesën ku parashikon se “...*Vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë*”, vjen në kundërshtim me Vendimin e GJEDNJ në çështjen “*Dauti kundër Shqipërisë*”. Si rrjedhojë, kjo dispozitë mbetet e pazbatueshme, për aq sa rregullimi ligjor për KMCAP nuk arrin të plotësojë kushtet e një organi *kuazi* gjyqësor. Në rastet ku kundërshtohet një vendim i KMCAP Epror, sipas këtij ligji, do të zbatohet drejtpërdrejtë ky vendim i GJEDNJ dhe dispozitat kushtetuese dhe ligjore të përgjithshme që garantojnë kontrollin gjyqësor mbi aktin administrativ.

[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/3553\\_merushe\\_shpata\\_vendim\\_njehsues\\_6252.doc](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/3553_merushe_shpata_vendim_njehsues_6252.doc)

\*\*\*\*\*

Kolegji Penal:

➤ Në çështjen penale me nr. 52810-227-2021 ka njësuar praktikën gjyqësore duke konkluduar se Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e të gjitha akuzave penale të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i KPP. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e akuzave penale në të cilat akuza në gjykim përfaqësohet nga prokuroria, si dhe për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm, sipas nenit 59 të KPP.

[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/227\\_5516.doc](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/227_5516.doc)

## Plani Strategjik i Veprimit për Gjykatën e Lartë

Bazuar në planet strategjike të KLGJ-së për vitet 2019 – 2020 (<http://klgj.al/wpcontent/uploads/2019/10/Plani-Strategjik-i-KLGJ-se-per-sistemin-Gjyqesor-2019-2020-versioni-shqip-1.pdf>), 2021 - 2023 dhe planet përkatëse të veprimit,

“Udhërrëfyesin për Funksonimin e Gjykatës së Lartë”, me mbështetjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe ndihmesën e vazhdueshme të partnerëve ndërkombëtarë, Gjykata e Lartë paraqet këtë plan veprimi për vazhdimësinë e suksesshme dhe qasjen e shtuar në drejtësi për të gjithë qytetarët. Gjykata e Lartë duhet të ngrihet në pozicionin e vet natyror në krye të sistemit gjyqësor dhe të shërbejë si pikë orientimi për praktikën gjyqësore të administruar në mënyrë të drejtë, të qartë dhe të unifikuar, duke fituar legjitimitetin e saj dhe rikthyer besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Në këtë kuadër, është ndërmarrë procesi i analizimit dhe vlerësimit të situatës dhe është hartuar ky plan veprimi për masat ligjore, institucionale dhe administrative përkatëse. Vëmendje dhe kujdes i veçantë i është kushtuar përfshirjes dhe dhënies përparësi rekomandimeve dhe praktikave të mira (CEPEJ -<https://www.coe.int/en/web/cepej>), të ofruara nga institucionet ndërkombëtare.

### **Objektivi Strategjik i Gjykatës së Lartë**

***Shndërrimi Gjykatës së Lartë në një gjykatë ligji që orienton praktikën gjyqësore, duke i kthyer asaj legjitimitetin institucional dhe rritur besueshmërinë në publik.***

#### **Synimi 1: Gjykimi efikas dhe në kohë i çështjeve**

Gjykata do të bashkëpunojë me të gjitha organet përkatëse për t'u siguruar që kuadri ligjor t'i lejojë të përdorë më së miri burimet e disponueshme (gjyqtarët dhe stafin e gjykatës), me qëllim rritjen e efikasitetit të saj.

**Synimi 2: Shtimi i burimeve, përmirësimi i metodave dhe proceseve të punës**

Gjykata do të shqyrtojë dhe përmirësojë rregullisht metodat e punës, duke bërë ndryshimet e nevojshme për të mbështetur gjykimin efikas dhe në kohë, krahas rritjes së nevojës për shtimin e numrit të këshilltarëve ligjorë që ecën paralelisht me

shtimin e numrit të gjyqtarëve deri në plotësimin e saj.

**Synimi 3: Dhënia përparësi uljes së numrit të çështjeve të prapambetura dhe parandalimit të krijimit të backlogut**

Gjykata do të punojë në mënyrë të vazhdueshme dhe këmbëngulëse për trajtimin e çështjeve aktuale të prapambetura, ndërkohë që përcakton proceset dhe protokollet e nevojshme për të parandaluar krijimin e çështjeve të prapambetura, në të ardhmen.

**Synimi 4: Rritja e transparencës dhe e komunikimit me publikun**

Gjykata do të shtojë dhe përmirësojë publikimin e gjykimeve, të dhënat dhe statistikat e performancës, si dhe do të përpiqet të jetë më proaktive në strategjinë e vet të komunikimit, në përputhje me Strategjinë e Komunikimit për vitin 2021 të KLGJ-së

**Synimi 5: Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar**

Gjykata do të angazhohet aktivisht me partnerët përkatës, vendas dhe ndërkombëtarë,

për të siguruar bashkëpunimin për përmirësimin e gjykatës dhe të gjyqësorit.

**Synimi 1: Gjykimi efikas dhe në kohë i çështjeve**

Sipas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të ndërmarra në kuadrin e reformës në

drejtësi në vitin 2016, roli i Gjykatës së Lartë brenda sistemit të gjyqësorit u rikonceptua në funksionin e saj kasacional, si autoriteti më i lartë për interpretimin përfundimtar të ligjit, nëpërmjet njësimin dhe zhvillimit të praktikës gjyqësore. Kështu, Gjykata e Lartë analizon në mënyrë të vijueshme legjislacionin e ri dhe, në bashkërendim me KLGJ-në, orientohet drejt hartimit dhe propozimit të ndryshimeve që sigurojnë harmonizimin midis ligjeve procedurale dhe materiale, të cilat ndikojnë në gjykimin efektiv të çështjeve gjyqësore, në të gjitha nivelet e gjyqësorit.

Në këtë kuadër, nëpërmjet ndryshimeve ligjore në legjislacionin procedural, të cilat

kanë hyrë në fuqi në 29 maj 2021, u përcaktuan mekanizma praktike dhe efektive në funksion të përmirësimit të gjykimit të ligjshmërisë, ku mund të përmenden: (i) vendosja e sistemit të filtrimit të çështjeve, (ii) përcaktimi dhe unifikimi i shkaqeve për të cilat lejohet paraqitja e rekursit, (iii) riformatimi i përbërjes së trupave gjyqësore në gjykimin e çështjeve të caktuara edhe me 3 gjyqtarë, (iv) roli i kolegjit në njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, (v) përcaktimi i çështjeve, të cilat gjykohen me procedurë të përshpejtuar, (vi) reduktimi i rekurseve apo kërkesave me natyrë abuzive, përmes

zbatimit të penaliteteve, kur është rasti, (vii) ripozicionimi i natyrës së dhomës së këshillimit, duke i atribuuar edhe shqyrtimin e çështjeve gjyqësore në themel, etj.

Miratimi i këtyre ndryshimeve ligjore do të ketë ndikim të ndjeshëm në drejtim të efektivitetit të gjykimit në Gjykatën e Lartë, për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave për reformim të strukturuar, uniform, racional dhe harmonik të procedimeve gjyqësore.

Objektivi final është shndërrimi i saj në gjykatë ligji, duke i kthyer asaj autoritetin që i ka njohur Kushtetuta në administrimin e drejtësisë.

Megjithatë, pavarësisht ndryshimeve pozitive të rregullave procedurale që normojnë gjykimin në Gjykatën e Lartë, të ndërmarra në kuadër të reformës në drejtësi, vlerësohet e nevojshme që procesi i gjykimit në këtë gjykatë të jetë në vëmendjen e të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë, sidomos gjykatave më të ulëta dhe avokatëve, me qëllim njohjen e tyre me natyrën e veçantë që paraqet ky lloj gjykimi.

<b>Veprimtaritë e synuara</b>	<b>Afati</b>	<b>Gjendja</b>
1.1 Hartimi, këshillimi dhe arritja e konsensusit për ndryshimet e nevojshme ligjore.	Përfunduar	Përfunduar
1.2 Mbështetja dhe pjesëmarrja aktive në procesin ligjbërës, lidhur me miratimin e të gjitha ndryshimeve të propozuara nga Kuvendi.	Përfunduar	
1.3 Zbatimi aktiv i ndryshimeve ligjore përmes trajnimit dhe rritjes së kapaciteteve të stafit të gjykatës dhe drejtuesve të gjykatave më të ulëta.	Sipas nevojës për të gjitha ndryshimet e miratuara	Gjykata vijon të sigurojë që këto ndryshime të zbatohen sa më shpejt dhe që zbatimi të bashkërendohet
1.4 Ngritja e kapaciteteve për stafin e Gjykatës së Lartë, gjyqtarët e gjykatave të shkallëve më të ulëta dhe stafin e bashkëpunëtorëve të përfshirë, me qëllim zbatimin e legjislacionit të ri dhe/ose të ndryshuar.	Sipas nevojës për të gjitha ndryshimet e miratuara	me bashkëpunëtorët
1.5 Zhvillimi i mbledhjeve periodike me stafin për të diskutuar zbatimin dhe identifikimin e fushave të bashkëpunimit me aktorë të tjerë të sektorit të	Sipas nevojës për të gjitha ndryshimet e miratuara	

drejtësisë		
1.6 Zhvillimi periodik i mbledhjeve me kryetarët dhe kancelarët e gjykatave të shkallëve më të ulëta dhe bashkëpunëtorët e jashtëm për të siguruar mirëkuptimin e ndryshimeve ligjore dhe proceset e rishikuara të punës të gjykatave.	Çdo tre muaj	

## Synimi 2: Shtimi i burimeve, përmirësimi i metodave dhe proceseve të punës

Arritja e synimeve dhe objektivave të përcaktuara në këtë plan veprimi kërkon plotësimin e 9 pozicioneve vakante të gjyqtarëve. Aktualisht, KLGJ-ja është duke i plotësuar këto vende dhe synon të vijojë me emërimet e tjera, përgjatë këtij viti. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 KLGJ-ja emëroi 4 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë dhe shpalli thirrjet për aplikim për tetë vende të tjera. Prej këtyre thirrjeve u emëruan 2 gjyqtarë në muajin korrik, ndërkohë që pritet kryerja e disa emërimeve të reja në muajt në vijim.

Mbështetja ligjore dhe administrative është me rëndësi të madhe për efikasitetin e gjykimit dhe të punës së vetë gjyqtarëve. Në këtë aspekt, Gjykata e Lartë i ka dhënë përparësi ngritjes dhe plotësimit të Njesisë së Shërbimit Ligjor, si një mekanizëm thelbësor dhe i drejtpërdrejtë në mbështetje të gjyqtarëve, për të siguruar një procedure vendimmarrje efikase dhe të bashkërenduar brenda Gjykatës. Evadimi i numrit të madh të çështjeve, në radhë të parë, kërkon gjyqtarë. Megjithatë, pasja e një drejtësie efektive, krahas nevojës për një numër më të madh gjyqtarësh, kërkon edhe shtimin e numrit të këshilltarëve ligjorë, të cilët janë të detyruar të përballojnë një ngarkesë mbi mesataren normale të përgatitjes së çështjeve. Aktualisht, Gjykata e Lartë ka 20 këshilltarë ligjorë (nga të cilët 5 ndihmësmagjistratë dhe 15 këshilltarë jo gjyqtarë),

ndërkohë që nevojiten 34 të tillë, sipas organigramës së miratuar, ku më shumë se gjysma e tyre duhet të jenë ndihmësmagjistratë të komanduar nga sistemi. Raporti 1:2 mes numrit të gjyqtarëve e këshilltarëve ligjorë, por edhe ruajtja e raportit 1:1 mes ndihmësmagjistratëve e këshilltarëve jogjyqtarë, shihet si një ndër zgjidhjet më të ngutshme dhe të domosdoshme për të shprehur në trajtimin efikas të numrit aktual të çështjeve të prapambetura në gjykatë.

Bazuar në nevojat specifike të Gjykatës së Lartë dhe të përmbushjes së objektivave të saj, ishte e domosdoshme edhe përshtatja e strukturës organizative të saj.

Këshilli i Gjykatës, si organi vendimmarrës për këtë qëllim, mbi bazën e vendimit të KLGJ-së për rregullat standarde të Gjykatës së Lartë, miratoi strukturën e re të saj. Kjo strukturë u gjet nga Këshilli si një model, ku shërbimet ndihmëse strukturohen apo kombinohen në mënyrë më optimale, me qëllim që të sigurohet mbështetje efikase ndaj veprimtarisë së trupës gjyqësore, si dhe të ofrohet një shërbim gjyqësor i shpejtë, cilësor dhe profesional për publikun dhe operatorët e sistemit të drejtësisë.

Duke qenë se në procesin e menaxhimit të dosjeve gjyqësore përfshihen një sërë hallkash e njësisish brenda strukturës së Gjykatës së Lartë është e nevojshme që të realizohet rishikimi i procedurave dhe praktikave administrative të punës së kësaj strukture me qëllim përmirësimin e saj, duke pasur si objektiv rritjen e efikasitetit të punës, reduktimin e kohës lidhur me menaxhimin e dosjeve gjyqësore, si dhe koordinimin më të mirë të punës brenda saj. Në përmirësimin e metodave të punës mbetet prioritet edhe hartimi i akteve procedurale me format të standardizuar. Qëllimi i standardizimit të akteve procedurale i shërben nevojës së rritjes së efikasitetit dhe produktivitetit të punës, strukturimit më të qartë e më konciz të përmbajtjes së akteve procedurale, në funksion të kuptueshmërisë dhe qartësisë së përmbajtjes, si dhe lehtësisë së riprodhimit standard të tyre. Për këtë qëllim, del i domosdoshëm konceptimi dhe hartimi i modeleve të akteve procedurale me format të standardizuar, (të tilla si: rekursi i paraqitur nga palët; relacioni i këshilltarit ligjor; vendime gjyqësore të thjeshta, të cilat nuk kanë nevojë për arsyetim të hollësishëm e të gjatë, formate vendimesh, sipas natyrës së çështjes etj.)

## Synimi 2.1 - Shtimi i burimeve

Veprimtaritë e synuara	Afati	Gjendja
2.1.1. Bashkëpunimi dhe komunikimi i vazhdueshëm me KLGJ-në për emërimin e gjyqtarëve, duke i vënë theksin fushave të legjislacionit, në të cilat gjykata ka numrin më të lartë të çështjeve të prapambetura	Në vazhdimësi deri sa të jenë emëruar 19 gjyqtarët	Shihni shënimet më lart në hyrjen e Synimit 2
2.1.2. Sigurimi i caktimit në kohë të të	Në vijim, deri në	Përkohësisht të caktuar



gjithë gjyqtarëve të rinj në trupat gjyqësore dhe rishpërndarja e çështjeve mes tyre, ndërkohë që ruhet shpërndarja e përshtatshme e gjyqtarëve ndërmjet kolegjeve	plotësimin e vendeve. Më pas, për çdo vit	në trupa gjykuese deri në emërimin e gjyqtarëve të rinj
2.1.3. Zgjerimi i Njesisë së Shërbimit Ligjor përmes emërimit të 2 (dy) këshilltarëve të tjerë ligjorë, por edhe të komandimit nga KLGJ e të paktën 5 (pesë) ndihmësmagjistratëve	Në proces emërimi, jo më vonë se muaji dhjetor	Njësia me 20 këshilltarë ligjorë në pritje të emërimeve dhe komandimeve të reja
2.1.4. Garantimi që për çdo raund të emërimit të gjyqtarëve të shoqërohet me emërimin/komandimin e një numri të përshtatshëm këshilltarësh ligjorë për arritjen dhe ruajtje e raportit 1:2 midis gjyqtarëve dhe këshilltarëve	Në vijim të procesit të emërimit të gjyqtarëve, edhe plotësimi me këshilltarë ligjorë	

## Synimi 2.2 - Përmirësimi i metodave dhe proceseve të punës

Veprimtaritë e synuara	Afati	Gjendja
2.2.1. Përcaktimi i rregullave të detajuara për numrin e këshilltarëve ligjorë dhe funksionimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor që do të miratohen nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve	Brenda vitit 2021	
2.2.2. Ngritja dhe funksionimi i Qendrës së Dokumentacionit dhe rekrutimi i personelit të kualifikuar	Brenda vitit 2021	
2.2.3. Fillimi i botimit të Buletinit Periodik të Gjykatës	Pas krijimit të Qendrës	
	Sipas nevojës	8 vende vakante, me

2.2.4. Emërimi i administratës në Gjykatën e Lartë sipas strukturës së miratuar (pa përfshirë këshilltarët ligjorë)		fillimin e procedurës për 5 rekrutime
2.2.5. Bashkëpunimi aktiv me KLGJ-në për të siguruar burime të mjaftueshme financiare për pjesën e mbetur të vitit 2021 dhe në kuadër të procesit të planifikimit të buxhetit për vitin 2022.	Çdo vit dhe në mes të çdo viti  Në vijimësi	Zbatimi i kontrollit paraprak të çështjeve brenda vitit 2021
2.2.6. Rishikimi i procedurave të brendshme administrative	Në vijimësi	
2.2.7. Miratimi i rregullave më të detajuara të brendshme të gjykatës, sipas përcaktimeve ligjore pas miratimit të rregullave të brendshme standard për Gjykatën e Lartë nga KLGJ-ja.	Në vijimësi	Formate të miratuara për: rekursin; raportin e këshilltarit ligjor; vendime të thjeshta gjyqësore
2.2.8. Hartimi i formateve standard të akteve procedurale për strukturim më të përmbledhur dhe për rritjen e kuptueshmërisë nga palët jashtë Gjykatës		

### Synimi 3: Dhënia përparësi uljes së numrit të çështjeve të prapambetura dhe parandalimit të backlogut

Numri aktual i çështjeve të regjistruara në Gjykatë që nuk kanë vendim përfundimtar paraqitet më poshtë në *Tabelën 1 - Ngarkesa e Çështjeve* dhe të gjithë ata që shqyrtojnë ngarkesën e punës së gjykatës duhet të kenë në vëmendje se, për qëllimet e planit të veprimit, çështje e prapambetur nënkupton **çdo çështje të regjistruar prej të paktën 24 muajsh**. Për qëllimet e këtij dokumenti, numri i çështjeve të prapambetura përbëhet nga çështjet e regjistruara në Gjykatë para korrikut të vitit 2019. Çështjet e regjistruara nga gushti i vitit 2019 e deri tani nuk konsiderohen ende si çështje të prapambetura. Në fokus të strukturave drejtuese të Gjykatës së Lartë, me mbështetjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe asistencën e vazhdueshme të partnerëve ndërkombëtare, ka qenë hartimi i një metodologjie për përcaktimin e hapave që do të ndërmerren për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura. Hartimi i kësaj metodologjie diktohet nga nevoja për të përcaktuar objektivat dhe masat që duhen marrë, më qëllim rikthimin e Gjykatës së Lartë në pozicionin e saj natyror si një gjykatë

ligji, e cila orienton drejt, qartë dhe në mënyrë të njësuar praktikën gjyqësore, duke rritur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Në këtë drejtim, ka përfunduar procesi i analizës dhe i vlerësimit të situatës, si dhe është hartuar plani i masave me natyrë ligjore, institucionale dhe administrative për reduktimin e backlogut në Gjykatën e Lartë, duke i'u referuar dhe rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare për këtë qëllim. Gjykata ka ndërmarrë veprimet në vijim për trajtimin e numrit të çështjeve të prapambetura:

- ❖ Është ndërmarrë një inventarizim i plotë për të gjitha çështjet e regjistruara aktualisht në Gjykatë;
- ❖ Në partneritet me donatorët ndërkombëtarë janë përfshirë në këtë proces inventarizimi dhe sistemimi edhe 12 NUNÇP dhe 2 personel Teknik mbështetës. Janë hartuar dhe miratuar planet e veprimit për llojet e veçanta të çështjeve, administrative, civile dhe penale. Këto plane përcaktojnë kategoritë e çështjeve që do të trajtohen me përparësi dhe brenda çdo kategorie të gjitha çështjet trajtohen sipas datës së regjistrimit të tyre.
- ✓ **koha e regjistrimit**

Gjykata është e prirur për të qenë rigorozë në shqyrtimin fillimisht të çështjeve që mbajnë datën më të hershme të regjistrimit të tyre. Të tre kolegjet kanë evidentuar dhe kanë shqyrtuar të gjitha çështjet e regjistruara më herët (duke filluar nga viti 2010 e në vijim), si ato për të cilat është vendosur nga kolegjet e mëparshme të shqyrtohen në seancë gjyqësore, ashtu edhe ato që duhet të shqyrtohen në dhomë këshillimi. Intensifikimi i punës së tre kolegjeve, në të gjithë ditët e javës dhe me një angazhim maksimal, sipas një planifikimi korrekt, ka bërë të mundur që të evadohen gradualisht të gjitha çështjet e hershme, që i përkasin viteve 2010-2013 dhe në ndonjë nga kolegjet edhe ato të viteve 2014 e 2015.
- ✓ **karakteri emergjent**

Çështjet me karakter emergjent që janë të lidhura me afatet e shkurtra që kërkon ligji për shqyrtimin e tyre, janë një tjetër orientim për veprimtarinë e tre kolegjeve. Një numër jo i vogël i këtyre çështjeve (si kompetenca, juridiksioni, kërkesat për pezullim apo revokim vendimi, rekursat e veçanta, çështjet e ekstradimit, të zëvendësimit të masave apo të përjashtimit të gjyqtarit, etj) shqyrtohen prej kolegjeve, krahas çështjeve të hershme që përbëjnë edhe numrin më të lartë të çështjeve të regjistruara në Gjykatë. Nga kjo kategori janë shqyrtuar:
- ✓ **Gjykim për herë të dytë ose të tretë në Gjykatën e Lartë, si dhe prishja e vendimeve nga Gjykata Kushtetuese**

Për shkak të një procesi të tejzgatur, si pasojë e rigjyimit të çështjeve në Gjykatë të Lartë apo si rrjedhojë e prishjes së vendimeve të saj nga Gjykata Kushtetuese, këto çështje kanë marrë përparësi me qëllim shqyrtimin e tyre përfundimtar.
- ✓ **Vendimet e ndërmjetme ose vendime jopërfundimtare**

Nisur dhe nga klasifikimi, këto çështje kanë mbetur për një kohë të gjatë pa u mbyllur për shkak të rekursit të paraqitur ndaj një vendimi të ndërmjetëm, si p.sh faza e pare e pjesëtimit, sigurim padie, si dhe vendimet jopërfundimtare. Duke qenë se këto vendime janë jopërfundimtare, vonesa në shqyrtimin e tyre sjell pasoja të konsiderueshme për procesin gjyqësor në tërësi. Për këtë arsye, janë klasifikuar si çështje për t'u shqyrtuar me përparësi nga Gjykata e Lartë.

✓ **Rekurset me të meta dhe të paraqitura jashtë afatit**

Për të tre kolegjet është vendosur që rekurset për çështjet, të cilat nuk plotësojnë kushtet formale për t'u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, të shqyrtohen me përparësi.

Kështu, në këtë kategori janë përfshirë rekurset e paraqitura jashtë afatit ligjor, rekurset për çështjet, në të cilat vlera e padisë nuk kalon 40 fishin e pages minimale (në fushën administrative) ose vlerën e padisë nën 150.000 lekë (në fushën civile), rekurset për të cilat është paraqitur kërkesa për heqje dorë etj.

✓ **Çështje të shqyrtuara për shkak të njësimimit të praktikës gjyqësore**

Njësimi dhe zhvillimi i praktikës gjyqësore mbetet funksioni kryesor i Gjykatës së Lartë. Ndjekja e një metodologjie që fokusohet drejt njësimimit të çështjeve më problematike, me synim tërheqjen në grup të çështjeve me të njëjtën natyrë, e bën shumë më efektiv gjykimin në Gjykatën e Lartë. Njësimi i praktikave të ndryshme gjyqësore apo ndryshimi i praktikave të mëparshme unifikuese jep zgjidhje për evadimin e shumë çështjeve që kanë mbetur pa zgjidhje për një kohë të gjatë.

✓ **Kategori të tjera**

Nisur nga sa më sipër, mund të thuhet se kategoritë e çështjeve për të cilat është vendosur përparësi në gjykim, përveç atyre të paraqitura më lartë, për të tri kolegjet janë:

*Çështje penale*

- Rekurset për çështje emergjente (amnistia, masat e sigurimit, mosmarrëveshjet për juridiksionin dhe kompetencën, ekstradimet dhe transferimet e procedimeve);
- Çështjet për të cilat gjykata e apelit ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim;
- Çështjet ku është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të formës së prerë;
- Kërkesat për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e gjykimit;
- Çështje për të cilat rekursi lidhet me zbatimin e nenit 59 të Kodit Penal;
- Çështje për të cilat gjykata e apelit ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
- Çështje për të cilat edhe i pandehuri dhe prokurori kanë paraqitur rekurs.

*Çështje administrative*

- Rekursitet për çështjet emergjente si mosmarrëveshjet për juridiksionin dhe kompetencën, kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë dhe revokimin e vendimit të pezullimit, kërkesat për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, kundërshtimi i vendimeve të ndërmjetme;
- Çështjet për të cilat gjykata e apelit ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
- Çështjet e gjykuara si shkallë e parë në apel: aktet normative, vendimet e ATP-së, vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil;
- Çështjet ku është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, sipas nenit 479 të KPC;
- Çështjet që kanë ardhur për herë të dytë ose më shumë në Gjykatën e Lartë.

#### *Çështje civile*

- Kërkesat për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit;
- Mosmarrëveshjet për juridiksionin dhe kompetencën;
- Kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë dhe revokimin e vendimit të pezullimit;
- Çështjet e gjykuara nga gjykata e apelit si gjykatë e shkallës së parë;
- Vërtetim i faktit juridik;
- Kundërshtim veprimesh përmbare;
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve të punës;
- Mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me familjen, lënien e fëmijëve për rritje e edukim.

- ❖ Çdo kolegji shqyrton vazhdimisht planin dhe bën rregullimet përkatëse për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e rrjedhës së punës.

*Tabela 1 - Ngarkesa e Çështjeve*

Viti	Administrative	Civile	Penale	Gjithsej
2010	0	2	0	2
2011	0	5	0	5
2012	3	11	0	14
2013	15	91	0	106
2014	89	905	2	996
2015	843	3067	3	3913
2016	1721	3649	816	6186
2017	3260	3463	1217	7940

<b>2018</b>	2743	3101	1593	7437
<b>2019</b>	2169	2418	865	5452
<b>2020</b>	1022	1106	525	2653
<b>2021</b>	384	903	618	1905
<b>GJITHSEJ</b>	12249	18721	5639	36609

Tabela 2 - Çështjet e Prapambetura

Lloji i çështjes	Çështje të regjistruara më të vjetra se 24 muaj
Çështje Administrative	16518
Çështje Civile	10634
Çështje Penale	4406
<b>Gjithsej</b>	<b>31558</b>

Veprimtaritë e synuara	Afati	Gjendja
3.1. Inventari i ngarkesës të çështjeve ekzistuese	Në vijim derisa të përfundohet	Gjithsej 22 995 (66% e të gjithë ngarkesës me çështje)
3.2. Sigurimi që të gjitha çështjet e përkufizuara ligjërisht si urgjente në grupin e çështjeve të prapambetura dhe ndër çështjet e regjistruara rishtas të futen në procesin e gjyimit	Vazhdimisht	çështje të arkivuara, inventarizuara dhe kategorizuara
3.3. Përcaktimi i planeve të veprimit për çdo kategori çështjesh dhe shqyrtimi i vazhdueshëm i këtyre planeve	Menjëherë pas inventarit	Përfunduar sa i përket çështjeve të prapambetura të inventarizuara
3.4. Përcaktimi i synimeve të performancës në Gjykatë për gjyqtarët, këshilltarët ligjorë dhe stafin, në mbështetje të uljes efikase të numrit të çështjeve të prapambetura dhe parandalimit të krijimit të kësaj kategorie në të ardhmen.		Shqyrtim sipas nevojës Brenda vitit 2021

## Synimi 4: Rritja e transparencës dhe e besimit të publikut

Gjykata e Lartë përdor faqen e saj zyrtare për shpalljen e informacionit publik lidhur me strukturën dhe organizimin e saj, vendimet gjyqësore, legjislacionin përkatës, njoftimet për orën dhe datën e shqyrtimit të çështjeve, njoftimet për përbërjen e trupës së gjyimit, vendimmarrjen e gjykatës, formatet e rekursit dhe informacione të tjera me dobi për publikun.

Me synimin për të bërë këto shpallje brenda afateve të përshtatshme, strukturat e Gjykatës bashkërendojnë punën e tyre për publikimin e dispozitivit të vendimit të marrë nga kolegji brenda ditës së punës, në përputhje me datën e shpalljes së seancës. Një çështje me përparësi është riformatimi i disa funksionaliteteve teknike të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë për t'i siguruar publikut qasje më miqësore dhe të shpejtë në informacion të saktë dhe të bollshëm lidhur me veprimtaritë gjyqësore dhe institucionale të saj.

Veprimtaritë e synuara	Afati	Gjendja
4.1. Hartimi i strategjisë së pranisë në publik për zbatimin e një fushate ndërgjegjësimit për rritjen e besimit	Përfunduar	Përfunduar
4.2. Mbledhja dhe publikimi i të dhënave që pasqyrojnë performancën e gjykatës.	Vazhdimisht	Zbatuar çdo muaj dhe në vazhdimësi
4.3. Informimi i publikut për ecurinë mujore të uljes së numrit të çështjeve të prapambetura dhe veprimtarive të tjera që lidhen me efikasitetin e Gjykatës	Vazhdimisht	Zbatuar çdo muaj dhe në vazhdimësi
4.4. Informimi proaktiv i publikut dhe i komunitetit të drejtësisë lidhur me ndryshimet e proceseve të punës dhe sigurimi që ata të kuptojnë të gjitha ndryshimet ligjore dhe nënligjore gjatë procesit të hyrjes së tyre në fuqi	Vazhdimisht	Zbatuar me ndryshimet më të fundit
4.5. Rritja e transparencës së gjykatës përmes përdorimit të faqes zyrtare dhe llogarive në media sociale	Vazhdimisht	Llogaritë e reja të mediave sociale janë krijuar dhe përdorimi vijon



## Synimi 5: Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar

Proceset efikase të Gjykatës kërkojnë bashkëpunim të vazhdueshëm me KLGJ dhe gjykatat e shkallëve të ulëta, si dhe me disa institucione publike dhe subjekte të interesuara në komunitet. Mungesa e komunikimit proaktiv ndikon jopozitivisht në përfitim të burimeve të përshtatshme për gjykatën dhe aftësinë e saj për të siguruar besimin e publikut.

Gjykata ka identifikuar si palë të interesuara dhe bashkëpunëtorë:

- ❖ Dhomën Kombëtare të Avokatisë
- ❖ Avokaturën e Shtetit
- ❖ Shoqërinë Civile
- ❖ Donatorët Ndërkombëtarë
- ❖ Ekspertët e Gjykatave
- ❖ Median

Veprimtaritë e synuara	Afati	Gjendja
5.1. Organizimi i mbledhjeve të përhershme me kryetarët dhe kancelarët e gjykatave	Çdo tre muaj	
5.2. Organizimi i takimeve me palët e interesit dhe bashkëpunëtorët	Sipas nevojës	
5.3. Organizimi i takimeve për koordinimin e donatorëve, me qëllim shmangien e veprimtarive të dyzuara ndërmjet donatorëve dhe maksimizimin e partneriteteve individuale dhe kolektive me donatorët	Sipas nevojës	

## Monitorimi dhe raportimi

Gjyqtarët, këshilltarët ligjorë dhe personeli i gjykatës do të vijojnë të rregullojnë procesin e tyre të punës për të arritur sa më shumë efikasitet dhe efektshmëri.

Gjykata do të vijojë të sigurojë zbatimin sa më shpejt të këtyre veprimeve, si dhe bashkërendimin me bashkëpunëtorët.

## Shqetësime të Gjykatës

Numri i madh i çështjeve të grumbulluar ndër vite në Gjykatën e Lartë mbetet një problem shqetësues dhe një sfidë për veprimtarinë e saj, gjë që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ecurinë e procesit të administrimit të shpejtë dhe efektiv të drejtësisë.

Arsyet që kanë çuar në krijimin e një numri të lartë të çështjeve të prapambetura në Gjykatë (backlogut) janë të ndryshme. Ato lidhen si me çështje superstrukturore, ashtu edhe infrastrukturore. Procedurat gjyqësore deri diku të ngurta, moskuptimi si duhet i juridiksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, mbajtja e qëndrimeve të ndryshme për çështje të njëllojta, mosplotësimi në kohë i vendeve vakante për gjyqtarë, aksesit i pakufizuar në paraqitjen e rekurseve, mungesa e një sistemi efektiv të filtrimit të çështjeve gjyqësore, apo krijimit të mekanizmave ligjore efektivë për frenimin e fluksit të prurjes së çështjeve në Gjykatën e Lartë, mungesa e një sistemi digjitalizimi modern dhe sipas kërkesave të kohës, janë disa nga mangësitë me të cilat është përballur kjo Gjykatë.

Plotësimi i numrit të gjyqtarëve dhe këshilltarëve ligjorë sipas organogramës do të rrisë eficensën, por ngrihen dyshime nëse do të mund të evadohen të gjitha çështjet e prapambetura brenda një kohe të shkurtër. Referuar ngarkesës aktuale të 15 këshilltarëve ligjorë, e cila është mesatarisht 25 çështje/muaj, rezulton se në një muaj numri i çështjeve të evaduara është 375, ndërsa për të gjithë vitin mund të jetë 4125. Për këtë arsye, nevojitet një shtim i ndjeshëm i numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë, të cilët do bëjnë të mundur përgatitjen në kohë të sa më shumë çështjeve që duhet të gjykohen nga trupat përkatëse. Nga ana tjetër, duhet mbajtur në vëmendje se ulja e backlogut përmes marrjes së vendimeve është e lidhur edhe me respektimin e ngarkesës që duhet të përballojë vetë gjyqtari i Gjykatës së Lartë.

Fakti se çdo gjyqtar duhet të përballojë një ngarkesë prej afro 500 çështje në vit është një arsye thelbësore për të rivlerësuar mundësinë për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në kuadrin e miratimit të hartës së re gjyqësore.